

***AKT – THEMELIMI***  
***I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR***  
***"AUTO ROY-AM" SHPK***

Sot me daten 14/02/2023 (dymijë e njëzet e tre), ne ortaket themelues :

- **1Z. DORJAN XHEBEXHIA**, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 11 Nëntor 1985, lindur në Nikoliq, Kukës dhe banues në Tiranë, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues i Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. I51111017V.
- **2 Z. KRESHNIK MUHAMETAJ**, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 19 Qershori 1985, lindur në Zogaj, Tropojë, dhe banues në Durrës, disponues i leternjoftimit (kartë identiteti), me Nr. I50619058G.

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit",

Kam vendosur të themeloj *Shoqërinë me Pergjegjësi të Kufizuar "AUTO ROY-AM" SHPK*.

***NENI 1.***  
***EMËRTIMI I SHOQËRISË***

Shoqëria do të quhet "*AUTO ROY-AM*" SHPK.

***NENI 2***  
***SELIA E SHOQËRISË***

Shoqëria do të ketë selinë e saj në, Valias, Tiranë, Ndëertesë me nr pasurie 54/82, vol 10, fq 146, zona kadastrale 1649.

***NENI 3***

***OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË***

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj ne fushen e:eksport ,import, tregti, dhënie me qera të automjeteve të tonazheve të ndryshme, agjensi imobiliare, blerje, shitje, dhënie me qera, ndërmjetësim për shitje dhe blerje të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të llojeve të ndryshme, ndërtesa, apartamente, toka truall dhe arë, pyje, njësi tregtare, garazhde. Ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mardhënisë me publikun, marketing dixhital nëpërmjet ofrimit të dizenjimit dhe menaxhimit të faqeve të rrjeteve sociale për qëllime marketing. Shërbime marketing online. Krijim, menaxhim, dhe shitje të faqeve website. Çdo gjë që i shërben aktivitetit dhe cdo gjë që lejon legjislacioni shqiptar.

***NENI 4***

## KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë "AUTO ROY-AM" **SHPK** është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Ky kapital është i ndarë në 2 kuota, me vlerë nominale 50.000 (pesëdhjetë mijë) secila.

Kontributi i ortakëve është i ndare si vijon:

- 1.DORJAN XHEBEXHIA zotëron 1 kuotë baraz me 50 % të kapitalit.**
- 2.KRESHNIK MUHAMETAJ, zotëron 1 kuotë baraz me 50 % të kapitalit.**

## **NENI 5 KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhe kohe të pacaktuar.

## **NENI 6 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administrator të shoqërisë do tëjenë

- 1- **Z.DORJAN XHEBEXHIA**, i cill emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.
- 2- Z. Kreshnik Muhametaj, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë përsëritje.

Administratoret mund te vepojne bashkerisht dhe vec e vec.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marredhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo përfajje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

## **NENI 7 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkressë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqerite Tregtare".
2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendorur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**NENI 8**

**NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit finanziar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

**Neni 9**

**LIKUJDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

**NENI 10**

**MOSMARRËVESHJET**

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Tirëanë për zgjidhje.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË  
"AUTO ROY-AM" SH.P.K**

**DORJAN XHEBEXHIA**

*Dorjan Xhebexhia*



**KRSHTNIK MUHAMETAJ**

*Kreshnik Muhametaj*

